



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

KURRIKULA ME ZGJEDHJE

Lënda: Gjeografi

Shkalla: VI

Klasa: XII

Tiranë 2017



PËRMBAJTJA

1. FUSHA “SHOQËRIA DHE MJEDISI”	2
1.1. HYRJE NË PROGRAMIN E GJEOGRAFISË.....	4
2. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT	7
2.1. QËLLIMET E PROGRAMIT TË GJEOGRAFISË	9
2.2. LIDHJA E KOMPETENCAVE KYÇE ME KOMPETENCAT E FUSHËS/LËNDËS	11
2.3. LIDHJA E LËNDËS SË GJEOGRAFISË ME TEMAT NDËRKURRIKULARE.....	19
2.4. LIDHJET E LËNDËS SË GJEOGRAFISË BRENDA FUSHËS DHE ME FUSHAT E TJERA TË TË NXËNIT	21
2.5. KOMPETENCAT E LËNDËS DHE TEMATIKAT E SAJ.....	23
2.6. KOHA MËSIMORE PËR TEMATIKË PËR KLASËN XII.....	26
3. REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS TEMATIKAVE PËR SHKALLËN E GJASHTË	27
TEMATIKA: NDËRVARËSIA MIDIS NJERËZVE, RAJONEVE DHE MJEDISEVE	28
REZULTATET E TË NXËNIT	29
NËNTEMATIKA: GJEOGRAFIA DHE PROCESET GLOBALIZUESE	29
NËNTEMATIKA: RAJONET GJEOGRAFIKE TË BOTËS.....	30
NËNTEMATIKA: SFIDAT E BOTËS GLOBALE	45
4. UDHËZIME METODOLOGJIKE.....	58
6. MATERIALET DHE BURIMET MËSIMORE	64

1. FUSHA “SHOQËRIA DHE MJEDISI”

Arsimi parauniversitar krijon kushte dhe mundësi që nxënësi të ndërtojë dhe të zhvillojë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike; të zhvillohet në mënyrë të pavarur e të gjithanshme; të kontribuojë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë; të përballet në mënyrë të suksesshme me sfidat e jetës.

Në arsimin parauniversitar, nxënësi:

- kultivon identitetin vetjak e kombëtar dhe përkatësinë kulturore;
- përvetëson vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
- zhvillohet në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike;
- zhvillon përgjegjësi ndaj vetes, të tjerëve, shoqërisë dhe mjedisit;
- aftësohet për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
- aftësohet për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- zhvillon shpirtin e sipërmarrjes;
- përdor teknologjitë e reja.

Fusha “Shoqëria dhe mjedisi” i krijon nxënësit mundësitë të zhvillojë kompetencat e nevojshme për të përmbushur rolin e tij si anëtar i një shoqërie shumëkulturore dhe demokratike, në një botë gjithnjë e më të ndërvarur. Kompleksiteti i botës shoqërore sot po rritet për shkak se shoqëritë janë në një proces të vazhdueshëm ndryshimi dhe lidhjesh globale, shoqëruar me rritje të lartë të lëvizshmërisë së popullsisë, shumëfishim të kontakteve midis kulturave të ndryshme, qarkullim të shpejtë të informacionit dhe rritje të globalizimit të ekonomisë. Lëndët që përbëjnë fushën “Shoqëria dhe mjedisi”, zhvillojnë te nxënësit të menduarin kritik e krijues, pasurojnë kulturën e tyre dhe i përgatisin ata të luajnë një rol aktiv në

një shoqëri demokratike. Ato nxitin zhvillimin intelektual të nxënësit duke i dhënë mekanizmat konceptualë dhe metodologjikë, të cilët nxënësi mund t'i përdorë në situata të ndryshme.

Në shkallën e gjashtë (klasa XII), fusha “Shoqëria dhe mjedisi” integron njohuri, zhvillon shkathtësi, edukon qëndrime dhe vlera nëpërmjet lëndëve “Gjeografi”, “Histori”, “Sociologji”, “Psikologji” dhe “Ekonomi”. Secila prej tyre e trajton botën dhe shoqërinë nga këndvështrime të ndryshme.

Përmes kësaj fushe, nxënësi zhvillon:

- konceptin e tij hapësinor për botën, për kompleksitetin dhe ndërvarësinë e vendeve dhe të rajoneve në botë. Nxënësi aftësohet të vlerësojë pasojat e ndërveprimit të shoqërisë me mjedisin, për të ndërmarrë veprime që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm;
- bazat e qytetarisë duke siguruar kuptimin e ligjshmërisë, të proceseve ekonomike, shoqërore e kulturore dhe të çështjeve që lidhen me to;
- konceptin e kohës, të vazhdimësisë dhe të ndryshimit në këndvështrimin e marrëdhënieve historike dhe zbaton këtë kuptim në analizën e pasojave të veprimeve individuale dhe kolektive në shoqëri, në të kaluarën dhe sot.

Në këtë shkallë, përvojat mësimore të kësaj fushe të nxëni i shërbejnë përmbushjes së kompetencave kyçe, me fokus të veçantë kultivimin e identitetit personal, shoqëror, kombëtar e kulturor.

1.1. HYRJE NË PROGRAMIN E GJEOGRAFISË

Gjeografia është shkencë e vendit, hapësirës dhe mjedisit. Ajo është një mënyrë e strukturuar e zbulimit, analizës dhe shpjegimit të dukurive dhe karakteristikave të Tokës, banorëve të saj dhe marrëdhënieve të ndërsjella midis tyre. Mësimi i gjeografisë i ofron nxënësit mundësi të kuptojë veçoritë natyrore dhe shoqërore të mjedisit gjeografik, diversitetin e vendeve dhe rajoneve në botë, të njerëzve dhe kulturave, ndërvarësinë dhe ndërveprimin, si dhe marrëdhëniet e njeriut me mjedisin në nivel lokal, rajonal dhe botëror.

Ndryshimet e shumta që po përjeton shoqëria e sotme, kanë modifikuar marrëdhënien tonë me mjedisin. Shumëllojshmëria e informacionit dhe shpërndarja marramendëse e tij, shtimi i shkëmbimeve të llojeve të ndryshme, globalizimi i ekonomisë dhe lëvizjet e popullsisë i bëjnë largësitë më të vogla dhe ndikojnë në mënyrën sipas së cilës ne shohim botën. Në këtë kuptim, lënda e gjeografisë ka një rëndësi të veçantë për përgatitjen e nxënësit për të jetuar dhe për t'u integruar në shoqëri, për kultivimin e identitetit personal, shoqëror, kombëtar dhe edukimin për të jetuar së bashku, për një zhvillim sa më të qëndrueshëm.

Programi i gjeografisë ndihmon në zhvillimin e kompetencave kyçe në funksion të të nxënës gjatë gjithë jetës. Zhvillimi i kompetencave është pikënisja dhe parimi bazë organizativ i këtij programi. Përmbajtja lëndore konceptohet si mjet për realizimin e tyre, nëpërmjet zhvillimit të situatave të të nxënës.

Nxënësi përvetëson mjetet dhe “gjuhën” gjeografike teksa hulumton marrëdhënien e njeriut me vendet dhe mjedisin, dhe zbulon rolin që duhet të përmbushë për zhvillimin e qëndrueshëm. Ai mëson t'u përgjigjet problemeve gjeografike duke përdorur prezantimet hapësinore që ka përdorur më parë, të cilat tashmë i modifikon dhe i zhvillon.

Vëzhgimet dhe puna me hartën, interpretimi i shpërndarjes hapësinore të veçorive natyrore dhe shoqërore të rajoneve të botës dhe ndërvarësive midis tyre, zhvillojnë shkathtësitë themelore gjeografike në këtë nivel shkollimi.

Hartimi i programit lëndor rrjedh nga Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar, nga kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të lartë dhe nga plani mësimor i gjimnazit.

Si i tillë, ky dokument u shërben:

-) **Nxënësit** për zhvillimin e kompetencave kyçe të të nxënit gjatë gjithë jetës dhe kompetencave të lëndës së gjeografisë, në mënyrë që ai të përballojë sfidat e jetës dhe të integrohet në shoqëri.
-) **Mësuesit** për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarive mësimore dhe të arritjeve të nxënësve në klasë dhe jashtë saj.
-) **Prindit** për njohjen e rezultateve të pritshme të fëmijës dhe kriterëve të vlerësimit.
-) **Hartuesit të teksteve mësimore** dhe të materialeve ndihmëse për mësuesit dhe nxënësit.

Zbatimi i programit bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore dhe fetare.

2. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT

Programi i gjeografisë për shkallën e gjashtë (klasa XII) të kurrikulës është konceptuar dhe hartuar në funksion të qasjes kurrikulare me bazë kompetencat.

-) Ky program krijon kushtet për zhvillimin e *kompetencave kyçe* dhe *kompetencave të lëndës* që lidhen me to. Kompetencat e lëndës lidhen me kompetencat kyçe nëpërmjet rezultateve të të nxënit të secilës prej tyre. Kjo lidhje siguron zhvillimin e ndërsjellë të tyre dhe mundëson integrimin lëndor.
-) Kompetencat zhvillohen përmes *tematikave të përbashkëta të fushës* dhe në program zërthehen në njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera. Tematikat e përbashkëta të fushës janë elemente të rëndësishme të programit të gjeografisë, sipas të cilave strukturohet përmbajtja lëndore dhe integrimi konceptual brenda fushës, në funksion të zhvillimit të kompetencave. Programi i gjeografisë për shkallën e gjashtë të kurrikulës është i strukturuar rreth tematikës “Ndërvarësia midis njerëzve, rajoneve dhe mjediseve”. Për këtë tematikë përcaktohen rezultatet e pritshme të shprehura në terma njohurish, shkathtësish dhe qëndrimesh. Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe nuk përmbushen jashtë tematikave. Ato janë marrë në konsideratë në të gjithë procesin e hartimit të rezultateve të të nxënit për tematikë duke qenë pjesë integrale e tyre.
-) Strukturimi dhe organizimi i programit për *shkallë kurrikule* synon ta bëjë këtë program më fleksibël, duke i ndihmuar dhe duke u lënë dorë më të lirë mësuesve që ta zbatojnë atë në mënyrë krijuese, si dhe të respektojnë ritmet individuale të nxënësve drejt zotërimit të kompetencave të detajuara në çdo shkallë të kurrikulës.
-) Strukturimi i programit mbi rezultatet e të nxënit për kompetencë ndihmon në planifikimin dhe zhvillimin e *situatave të të nxënit* dhe lehtëson vlerësimin e nxënësit për kompetencat kyçe. Situatat e të nxënit janë situata që lidhen me kontekstin e të nxënit. Ato mund të jenë

situata në mjedise të mbyllura ose të hapura të nxëni, brenda shkollës ose jashtë saj. Roli i mësuesit në mësimdhënien përmes situatave është ai i udhëheqësit dhe i lehtësuesit gjatë nxënies aktive të nxënësit.


-) Konceptimi i kurrikulës me bazë kompetencat krijon mundësitë dhe kërkon zbatimin e integruar të saj. Programi i gjeografisë krijon mundësi *integrimit brenda fushës dhe me fushat e tjera*, si: shkencat e natyrës, matematika, gjuhët dhe komunikimi etj. Në shumë aspekte, programi i gjeografisë përqendrohet në zhvillimin e temave të mëdha ndërkurrikulare, të cilat shërbejnë si çështje kyçe për zhvillimin e kompetencave, integrojnë fushat e të nxënit dhe synojnë të ndihmojnë nxënësin të lidhë shkollimin e tij me jetën e përditshme.
-) Programi sugjeron *metoda, teknika, strategji të mësimdhënies e të nxënies* që nxisin interesin, gjithëpërfshirjen, ndërveprimin dhe punën kërkimore të nxënësve. Përzgjedhja dhe përdorimi i tyre nga mësuesit bëhet në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve, duke respektuar stilet e ndryshme të të nxënit të tyre.
-) *Vlerësimi*, si pjesë integrale e procesit të të nxënit, mat shkallën në të cilën kompetencat janë arritur nga nxënësit. Vlerësimi merr shumë forma, të cilat i parashikon dhe i mundëson struktura dhe konceptimi i programit.

2.1. QËLLIMET E PROGRAMIT TË GJEOGRAFISË

Programi i gjeografisë për shkallën e gjashtë synon që nxënësi:

-) të zhvillojë dijet për dukuritë gjeografike, fizike dhe humane, në shkallë të ndryshme, mbi bazën e ballafaqimit të vazhdueshëm të të menduarit kritik e krijues;
-) të zhvillojë kuptimin për rajonet dhe rajonizimin, për veçoritë natyrore dhe humane të mjedisit gjeografik dhe të rajoneve në botë;
-) të zhvillojë interesin dhe respektin për vendin ku jeton, për vende të tjera, për njerëzit dhe mënyrën si ata ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe me mjedisin ku jetojnë;
-) të kuptojë mundësitë dhe sfidat e ndërvarësisë globale;
-) të zhvillojë shkathtësitë për të qenë përdorues kritik e krijues i metodave të kërkimit gjeografik;
-) të edukohet si qytetar i informuar, i përgjegjshëm dhe aktiv, i cili mund të kontribuojë për zhvillimin e një bote të qëndrueshme.

Diagrami 1: Korniza konceptuale e programit për klasën XII



2.2. LIDHJA E KOMPETENCAVE KYÇE ME KOMPETENCAT E FUSHËS/LËNDËS

Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyçe nga nxënësi gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies kërkon që mësuesi të mbajë parasysh lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës për secilën shkallë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat dhe mjetet e përshtatshme të procesit të të nxënies. Kompetenca përcaktohet si ndërthurje e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që një nxënës duhet të fitojë dhe të përdorë gjatë procesit të nxënies.

Kompetenca qytetare

Programi i gjeografisë, si pjesë e fushës “Shoqëria dhe mjedisi”, krijon kushte në mënyrë të veçantë për ndërtimin dhe demonstrimin nga nxënësi të kompetencës qytetare. Përmes kërkimit gjeografik për çështje, të tilla si ndërvarësia, shfrytëzimi i burimeve natyrore, qëndrueshmëria mjedisore në nivel lokal e global etj., nxënësi nxitet të mendojë në mënyrë kritike dhe të marrë vendime që ndihmojnë në zhvillimin e tij si individ.

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit

Programi i gjeografisë krijon mundësi për zhvillimin e shkathtësive komunikuese. Nxënësi përdor materiale të ndryshme për të eksploruar dukuritë, proceset gjeografike, vendet dhe rajonet. Përmes diskutimeve, debateve apo prezantimeve të punimeve e detyrave që ndërmerr, nxënësi zhvillon shkathtësi të të shprehurit, zhvillon dhe përdor në mënyrë progresive fjalorin gjeografik për të komunikuar idetë në mjedis të ndryshme.

Kompetenca e të menduarit

Programi i gjeografisë mundëson zbatimin e shkathtësive matematikore për kryerjen e analizave statistikore, ndërtimin e grafikëve, tabelave, llogaritjen dhe interpretimin e të dhënave. Në punën me hartën, nxënësit punojnë me koncepte numerike, të tilla si: shkalla, largësia, koordinatat, projektionet.

Nxënësi nxitet të zhvillojë aftësi të të menduarit kritik dhe krijues gjatë vlerësimit të të dhënave dhe përdorimit të tyre, teston shpjegimet dhe analizon argumentet. Ai zhvillon shkathtësi për marrjen e vendimeve dhe strategji që e ndihmojnë të mendojë në mënyrë analitike dhe logjike. Programi mundëson që nxënësi të kuptojë vlerën dhe procesin e drejtimit të pyetjeve, të jetë krijues e të zhvillojë imagjinatën përmes veprimtarive të ndryshme në klasë.

Kompetenca e të mësuarit

Në procesin e kërkimit gjeografik, nxënësi zhvillon kompetencën e të mësuarit. Programi mundëson që nxënësi të shfrytëzojë në mënyrë efektive përvojat paraprake për zgjidhjen e situatave të ndryshme dhe realizimin e veprimtarive; të parashtrijë pyetje për çështje të ndryshme dhe të organizojë mendimet për të gjetur përgjigje për një situatë/problem të caktuar gjeografik. Nxënësi aftësohet të paraqesë/skicojë idetë e tij për ecurinë dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarive, duke dhënë argumente para të tjerëve. Për këtë, shfrytëzon në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në ndonjë burim informacioni, vlerëson vetë performancën dhe rezultatin e arritur, duke iu referuar qëllimeve fillestare.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësit vlerësojnë rëndësinë e punës individuale dhe në grup për zhvillimin e komunitetit nëpërmjet shembujve konkretë nga jeta e përditshme, zgjidhin çështje të ndryshme që lidhen me mjedisin gjeografik, analizojnë elemente të situatës dhe kompleksitetin e saj, vlerësojnë rëndësinë dhe efektivitetin e zgjidhjeve të propozuara nga njëri-tjetri.

Kompetenca personale

Programi i gjeografisë nxit të nxënit bazuar në kërkim, duke zhvilluar aftësinë e nxënësve për të menaxhuar veten. Nxënësit kuptojnë rolin e tyre në procesin e të nxënit dhe në kryerjen e hetimeve, aftësohen të jenë të pavarur në zbatimin e njohurive e të shkathtësive dhe në marrjen e vendimeve. Përmes punës në bashkëpunim, nxënësit zhvillojnë aftësitë ndërpersonale dhe mësojnë të vlerësojnë perspektivat e ndryshme të anëtarëve të tjerë të grupit.

Kompetenca digjitale

Nxënësi zhvillon kompetencën digjitale përmes përdorimit të TIK-ut në mënyrë efektive dhe të përshtatshme kur heton, krijon, komunikon idetë dhe informacionin për proceset e dukuritë gjeografike për rajonet dhe vendet në botë, proceset globalizuese dhe shpërndarjen hapësinore të tyre.

Diagrami 2: Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së gjeografisë në shkallën e gjashtë

SHKALLA VI

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit

Nxënësi:

-) Shpreh, para një audience të caktuar mësimore, çështjet thelbësore të ngritura në një punim për një temë të caktuar, përmes së paku një forme të komunikimit (gjuhës, simboleve, shenjave, kodeve etj.).
-) Diskuton në grup, në mënyrë konstruktive, duke dhënë informacion e argumente dhe duke shtruar pyetje në një dialog në kohëzgjatje prej disa minutash, për një temë të caktuar në gjeografi.
-) Përdor drejt strukturën dhe rregullat standarde të drejtshkrimit të gjuhës në një numër të caktuar të konteksteve, si: ese, prezantime etj.
-) Prezanton në mënyrë efektive për një temë të caktuar nga rajonet gjeografike të botës dhe çështjet globale, komunikon me audiencën duke përdorur TIK-un dhe mediat e tjera të shkruara dhe elektronike.

Kompetenca e të menduarit

Nxënësi:

-) Sqaron ecurinë e zgjidhjes së një problemi, duke e vërtetuar zgjidhjen e problemit përmes analizës dhe e prezanton para moshatarëve apo të tjerëve.

-)] Analizon, në mënyrë të pavarur, informacionet e marra nga burimet e ndryshme për një temë ose detyrë të dhënë, vlerëson cilësinë e tyre dhe i radhit ato sipas rëndësisë dhe qëllimit që kanë (temat mund të jenë, p.sh.: ekonomia globale, ndryshimet klimatike etj.).
-)] Gjykon rezultatet e arritura nga analiza e të dhënave të një projekti të realizuar dhe i interpreton ato.
-)] Hulumton në mënyrë të pavarur për një çështje të caktuar, duke përcaktuar fazat dhe procedurat e hulumtimit, paraqet dhe interpreton rezultatet e fituara në tabela dhe grafikë, duke përdorur teknologjinë e informacionit.
-)] Identifikon burimet e informacioneve të nevojshme dhe i shfrytëzon ato në mënyrë të duhur për të zgjidhur një problem në nivelin e caktuar të vështirësisë, duke dhënë shembuj konkretë.
-)] Vlerëson cilësinë e informacioneve në një material të shkruar për një temë të caktuar (p.sh.: për ngrohjen globale, për shumëllojshmërinë kulturore etj.); identifikon elementet kryesore; i diskuton ato me moshatarë, duke dhënë propozime konkrete për shfrytëzimin e shembujve pozitivë në kontekstin lokal apo global, duke shprehur qëndrimin personal.
-)] Përpunon në mënyrë kritike informacionet e mbledhura nga burime të ndryshme për ndonjë temë të ndjeshme në shoqëri, formon qëndrim kritik dhe e paraqet atë gjatë një debati me moshatarë dhe me të tjerë për çështjen e ngritur, pro ose kundër (si, p.sh., nëse ndryshimet klimatike janë pasojë e veprimtarisë njerëzore etj.).

Kompetenca e të mësuarit

Nxënësi:

-)] Demonstron shkathtësi të përdorimit të TIK-ut në situata të përditshme dhe në përmbushjen e kërkesave të ndryshme gjatë të nxënit (p.sh.: për ndërtimin e tabelave, grafikëve apo diagrameve, për përgatitjen e prezantimeve etj.).
-)] Diskuton në grup për mënyrat e bashkëpunimit me të tjerët për të zgjidhur një situatë të re mësimore, tregon mënyrën e shfrytëzimit të

përvojave paraprake për të zhvilluar njohuritë dhe shkathtësitë e reja në zgjidhjen e situatave dhe problemeve të tilla.

-) Bën përpunimin e informacioneve për një temë të caktuar në mënyrë të pavarur dhe efektive, rezultatet e punës i prezanton me shkrim ose me gojë para të tjerëve, duke dhënë shpjegime për mënyrën e zgjedhjes dhe të shfrytëzimit të burimeve të informacionit.
-) Paraqet një plan studimi (në formë skice, vizatimi, shkrimi etj.) për ndonjë çështje të caktuar (p.sh., vlerat kulturore të një rajoni të caktuar etj.) duke respektuar të gjithë hapat e planit të studimit dhe e paraqet para të tjerëve.
-) Përzgjedh punimet kryesore të dosjes së vet për të shpjeguar para një audience të caktuar strategjitë që ka zbatuar për të ndjekur avancimin e vet dhe masat e aplikuara për të përmirësuar përparimin në mënyrë të vazhdueshme.
-) Vlerëson në mënyrë kritike punën e vet, duke iu referuar qëllimeve fillestare të punës, me qëllim përmirësimin e organizimit të punimit, qartësisë së mendimit etj.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësi:

-) Argumenton me shembuj konkretë lidhjet midis punës, profesionit dhe karrierës, prezanton vendimmarrjen personale referuar mundësive në dispozicion për arsimim/trajnim të mëtejshëm, si dhe argumenton zgjidhjet për realizimin e planit personal të karrierës.
-) Planifikon dhe menaxhon me sukses një projekt me objektiva të caktuar.
-) Paraqet, nëpërmjet njërës prej formave të shprehjes, kompetencat e nevojshme për përballimin e situatave të ndryshme jetësore apo për zhvillimin e karrierës në një fushë të caktuar.

Kompetenca personale

Nxënësi:

-) Demonstron vetëbesim dhe shkathhtësi personale e ndërpersonale, duke dalluar aspektet pozitive për veten dhe duke ndërmarrë veprime konkrete për arritjen e rezultateve personale të synuara.
-) Zgjidh konfliktet ndërpersonale në mënyrë konstruktive, duke shqyrtuar alternativat, duke marrë vendime dhe duke shpjeguar zgjedhjet e bëra.
-) Shfaq në forma të ndryshme ndërgjegjësimit për menaxhimin e emocioneve, stresit dhe konflikteve në situata të ndryshme etj.

Kompetenca qytetare

Nxënësi:

-) Prezanton, nëpërmjet njërës prej formave të shprehjes, mënyrën e funksionimit të mjedisit shoqëror në nivel lokal dhe më gjerë, si dhe me shembuj konkretë tregon kontributin e vet në ruajtjen dhe kultivimin e vlerave të mjedisit.
-) Paraqet në forma të ndryshme të shprehurit vlerat kryesore të diversitetit në shoqëri apo në mjedisin ku jeton, i diskuton ato me të tjerët, duke i krahasuar me shembuj nga jeta e përditshme që tregojnë tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve.
-) Prezanton, në një debat me të tjerët ose në një formë tjetër të shprehurit, masat për mbrojtjen dhe avancimin e vlerave dhe parimeve të drejtave të njeriut në jetën e përditshme, duke veçuar shembuj konkretë të ndonjë veprimtarie (p.sh.: veprimtari për promovimin e barazisë gjinore, për luftimin e paragjyqimeve dhe diskriminimit, për luftimin e varfërisë etj.).
-) Ilustron me shembuj zgjidhjen e problemeve të caktuara, si dhe e arsyeton atë me argumente para një audience të caktuar.

-)] Merr pjesë në përgatitjen dhe organizimin e një veprimtarie (në shkollë apo në komunitet) për mbrojtjen e mjedisit natyror dhe atij të krijuar nga njeriu, dhe kontribuon në mënyra të ndryshme për zhvillim të qëndrueshëm të mjedisit.

Kompetenca digjitale

Nxënësi:

-)] Përdor programet e TIK-ut në mënyrë efektive për të komunikuar dhe bashkëpunuar me bashkëmoshatarët gjatë procesit të të nxënit, duke përfshirë edhe të nxënit në distancë.
-)] Prezanton një projekt, duke përdorur sekuenca animimesh, videosh, figurash për demonstrimin e temave mësimore.
-)] Vlerëson cilësinë e informacionit të gjetur nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediash.
-)] Ndërgjegjësohet mbi globalizmin dhe larminë e kulturave, duke shkëmbyer përvojat e vendit tonë me nxënësit e vendeve të ndryshme.

Për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës, mësuesi ndjek këta hapa:

- përzgjedh përmbajtjen mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënit të kompetencave të gjeografisë në një vit mësimor, si dhe rezultatet e të nxënit për kompetencat kyçe;
- planifikon mësimdhënien, duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do të arrijë rezultatet e të nxënit për kompetencat kyçe brenda vitit mësimor;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave e projekteve për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënit për vit mësimor dhe shkallë në lëndën e gjeografisë.

2.3. LIDHJA E LËNDËS SË GJEOGRAFISË ME TEMAT NDËRKURRIKULARE

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore me të cilat përballlet shoqëria. Ato i shërbejnë zhvillimit të kompetencave dhe synojnë të ndihmojnë nxënësin të lidhë shkollimin e tij me jetën e përditshme. Në shumë aspekte, programi i gjeografisë përqendrohet në zhvillimin e temave të mëdha ndërkurrikulare, kryesisht në temat:

-) Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.
-) Zhvillimi i qëndrueshëm.
-) Mjedi.
-) Ndërvarësia.
-) Bashkëjetesa paqësore.

Programi ndihmon për edukimin e identitetit kombëtar, njohjen e kulturave, ndërvarësinë dhe bashkëjetesën paqësore.

Duke analizuar marrëdhëniet e shoqërisë me mjedisin nga perspektiva e menaxhimit të përgjegjshëm, nxënësi mëson të vendosë lidhjen midis nevojave dhe përdorimit racional të burimeve. Ai ndërgjegjësohet për aspektet shoqërore të konsumit, për implikimet e globalizmit për shoqërinë dhe shpërndarjen e burimeve. Ky ndërgjegjësim e ndihmon nxënësin të kuptojë më mirë ndërvarësinë e mjedisit nga veprimtaria njerëzore. Në këtë mënyrë, programi ndihmon për edukimin për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mjedisin.

Përmes studimit të vendeve dhe rajoneve të ndryshme, transferimit të të nxënit në vendin e tij, nxënësi ndërgjegjësohet për rolin e tij si qytetar. Kjo e ndihmon atë të jetë mendjehapur dhe të respektojë diversitetin. Nxënësi ndërgjegjësohet për të drejtat e tij, ndërvarësinë e njerëzve, konfliktet ndërkombëtare dhe nevojën për të zhvilluar kulturën e paqes.

Zhvillimi i karrierës

Një ndër synimet kryesore të programit të gjeografisë në shkallën e gjashtë është të zhvillojë orientimin për karrierat që lidhen me fushën e studimit të gjeografisë dhe me dimensione të saj, të tilla si: i gjeografit, i meteorologut, i sizmologut etj.

2.4. LIDHJET E LËNDËS SË GJEOGRAFISË BREnda FUSHËS DHE ME FUSHAT E TJERA TË TË NXËNIT

Konceptimi i programit të gjeografisë në fushën “Shoqëria dhe mjedisi” është mbështetur në parime të mirëfillta të integritimit. Për t’i siguruar nxënësit zhvillimin e kompetencave, është e rëndësishme lidhja e lëndëve brenda fushës, të cilat ndihmojnë në mënyrë të ndërsjellë njëra-tjetrën.

Lidhja e gjeografisë me historinë i shërben nxënësit të kuptojë më mirë ndryshimet që kanë pësuar kulturat e ndryshme dhe ndikimin e tyre në zhvillimet e vendeve dhe rajoneve, si dhe sfidat e ndërvarësisë globale. Nxënësi hulumton mbi historinë e mendimit gjeografik për të kuptuar evolucionin e ideve dhe teorive.

Lidhja e gjeografisë me qytetarinë ndihmon në zhvillimin e dimensioneve të qytetarisë. Nxënësi e sheh botën si bashkësi globale dhe të ndërvarur. Ai identifikon probleme, sugjeron zgjidhje dhe reflekton për marrjen e vendimeve. Gjeografia u jep aktualitet më të madh çështjeve me të cilat merret qytetaria dhe ndihmon në debate për çështje dhe ngjarje të rëndësishme.

Gjeografia është ngushtësisht e lidhur me fushat e tjera të të nxënit.

Si të gjitha lëndët e tjera, gjeografia krijon mundësi të zbatimit të kompetencave që zhvillon fusha “Gjuhët dhe komunikimi”. Gjuha është themelore për të nxënit e nxënësve në lëndën e gjeografisë. Nxënësi përzgjedh strategjitë e përshtatshme gjuhësore për të eksploruar, për të prezantuar dhe për të komunikuar të kuptuarin e dukurive gjeografike. Ai përdor gjuhën letrare për të shprehur pozicionin e tij qartë dhe në mënyrë koherente. Njëkohësisht, edhe gjeografia ndihmon në zgjerimin dhe përpunimin e fjalorit të nxënësit, duke e nxitur atë të parashtojë qartë dhe saktësisht idetë e tij, me gojë ose me shkrim. Punët praktike, projektet dhe detyrat që nxënësi realizon, i mundësojnë zhvillimin e kompetencës së komunikimit gjuhësor dhe pasurimin e fjalorit terminologjik. Termat e ndryshme, të përdorura në këtë lëndë, janë specifike dhe ndihmojnë nxënësin për zhvillimin e kompetencës së komunikimit përmes përdorimit të gjuhës dhe terminologjisë gjeografike.

Gjithashtu, e rëndësishme është *lidhja e gjeografisë me shkencat e natyrës*. Gjeografia është një urë lidhëse ndërmjet shkencave natyrore dhe atyre shoqërore. Shumë prej njohurive të fushës së shkencave natyrore janë themelore për kuptimin dhe interpretimin e dukurive gjeografike në Tokë. P.sh., zbatimi i ligjit të tërheqjes së gjithësisë për të shpjeguar tërheqjen e Tokës, Hënës, qëndrimin e planetëve në orbitën rreth Diellit; njohuritë mbi natyrën e valëve gjatësore dhe procesin e përhapjes së tyre në mjedis për të interpretuar valët detare; vetitë dhe përbërja e lëndës për të kuptuar mineralet; zbatimi i periodës së gjysmëzbërthimit dhe metodës së atomeve të shënuara të dukurisë së radioaktivitetit për të përcaktuar moshën absolute të shkëmbinjve etj., janë shembuj të zbatimit të ligjësisë dhe teorive shkencore në dukuritë gjeografike.

Lidhja e gjeografisë me matematikën. Nxënësi zhvillon njohuritë matematikore përmes përdorimit të informacioneve sasiore dhe cilësore, leximit apo ndërtimit të hartave, grafikëve dhe tabelave statistikore. P.sh., nxënësi llogarit mesataren ditore, mujore apo vjetore të temperaturave të ajrit; llogarit kohën lokale e zonale mbi bazën e veprimeve me thyesa; ndërton grafikë të shpërndarjes së reshjeve dhe të temperaturës dhe i interpreton ato. Nxënësi ndërton diagrame që paraqesin strukturën e popullsisë së një vendi apo rajoni, të ekonomisë dhe sektorëve të saj etj.

Lidhja e gjeografisë me TIK-un. Teknologjia e informacionit dhe komunikimit (TIK) mbështet të nxënit në lëndën e gjeografisë përmes realizimit të detyrave të ndryshme, projekteve, kërkimit, përpunimit dhe prezantimit të informacionit. Nxënësi mëson të përzgjedhë informacionin dhe të mbajë qëndrim kritik ndaj tij, të dallojë faktin nga opinioni. Nxënësi mund të përdorë *word-processor* në shkrimin e materialeve, zbaton hedhjen e të dhënave në tabelë për ndërtimin e grafikëve, përdor *PowerPoint* për prezantimin e një detyre, kërkon në internet harta dhe përcakton vendndodhjen e objekteve të ndryshme.

2.5. KOMPETENCAT E LËNDËS DHE TEMATIKAT E SAJ

Përmes programit të gjeografisë, në shkallën e gjashtë të kurrikulës, mundësohet zhvillimi i kompetencave të lëndës, të cilat lidhen me kompetencat kyçe që një nxënës duhet të zotërojë gjatë gjithë jetës. Programi i gjeografisë, nëpërmjet të gjitha tematikave të tij dhe situatave të të nxënësve, zhvillon dhe ndërton kompetencat e lëndës, të cilat janë pjesë e kërkimit gjeografik.

Tematikat mbi të cilat është organizuar përmbajtja e programit kanë të bëjnë me njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, nëpërmjet të cilave do të realizohen këto kompetenca. Shkathtësitë dhe qëndrimet, ashtu sikurse njohuritë, janë objekt i të nxënësve të rregullt dhe progresiv. Shkathtësitë dhe aftësitë u lejojnë nxënësve që, nën udhëheqjen e mësuesit apo në mënyrë të pavarur, të ndërtojnë, të përvetësojnë, të organizojnë njohuritë dhe të reflektojnë mbi to.

Disa nga shkathtësitë janë specifike për gjeografinë (p.sh., nxënësit lokalizojnë, orientohen në hapësirë, lexojnë dhe përdorin gjuhën hartografike), ndërsa të tjerat kanë të bëjnë me shkathtësi që gjeografia ndan me fushat e tjera dhe që janë të domosdoshme për të gjithë procesin e të nxënësve (p.sh.: komunikojnë me shkrim dhe me gojë, përshkruajnë, identifikojnë etj.). Çdo situatë të nxënësve shoqërohet, pa dyshim, me shumë prej këtyre shkathtësive.

Në shkallën e gjashtë, programi i gjeografisë zhvillon kompetencat e mëposhtme lëndore, të cilat lidhen me kërkimin gjeografik:

-) *Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.*
-) *Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit.*
-) *Marrja e vendimeve mbi bazën e informacionit të mbledhur.*

Tabela: Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës në shkallën e gjashtë

SHKALLA VI

Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike

Nxënësi:

- J përcakton një çështje gjeografike për kërkim;
- J formulon pyetje për një çështje gjeografike, gjen argumente, propozon zgjidhje dhe e mbrohet atë;
- J përcakton marrëdhëniet shkak-pasojë të dukurive gjeografike që ndodhin në rajone të ndryshme të botës;
- J identifikon modele hapësinore të dukurive dhe proceseve gjeografike dhe shpërndarjen e tyre;

Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit

Nxënësi:

- J përdor burime informacioni që mund të ndryshojnë besueshmërinë e tyre;
- J përzgjedh burimet më të përshtatshme nga tërësia e burimeve parësore (intervista, statistika etj.) dhe dytësore (grafikë, harta, ilustrime, video, CD, internet etj.), duke vlerësuar në mënyrë kritike vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre;
- J përdor mjetet gjeografike (hartat, fotografi etj.) dhe teknologjinë, për të ndërtuar njohuri për proceset e dukuritë për rajonet dhe veçoritë e tyre, ndërvarësinë, bashkëveprimin midis tyre, në nivel kombëtar, rajonal e global;

) komunikon (me shkrim, me gojë, grafikisht, vizualisht) shpërndarjen hapësinore të dukurive gjeografike, përmes përdorimit të hartave të shkallëve të ndryshme duke përdorur fjalorin e përshtatshëm gjeografik.

Marrja e vendimeve

Nxënësi:

-) komunikon ide komplekse dhe jep shpjegime koherente dhe të qëndrueshme (me gojë, me shkrim, në rrugë grafike), duke përzgjedhur gjuhën dhe fjalorin gjeografik;
-) identifikon pasojat që mund të shoqërojnë zgjidhjen e çështjes;
-) identifikon rrugë të ndryshme të veprimit;
-) përdor pyetje për të reflektuar në çdo fazë të kërkimit: “Çfarë funksionoi?”, “Si mund të përmirësohet?”.

2.6. KOHA MËSIMORE PËR TEMATIKË PËR KLASËN XII

Programi i gjeografisë për klasën XII zhvillohet në 136 orë mësimore gjithsej. Në program specifikohen orët e sugjeruara për secilën nëntematikë. Orët e sugjeruara përfshijnë njohuritë e reja, punët praktike, detyrat dhe projektet, testimet e ndryshme, prezantimin dhe vlerësimin e portofolit të të nxënit. Sasia e orëve mësimore për secilën nëntematikë është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, por janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara.

SHKALLA VI

Klasa XII

(4 orë mësimore/javë x 34 javë = 136 orë)

Tematika	Nëntematikat	Orë të sugjeruara
Ndërvarësia midis njerëzve, rajoneve dhe mjediseve. (136 orë)	Gjeografia dhe proceset globalizuese	5
	Rajonet gjeografike të botës	81
	Sfida të botës globale	50

3. REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS TEMATIKAVE PËR SHKALLËN E GJASHTË

Në programin e gjeografisë për klasën XII janë paraqitur rezultatet e të nxënit për tematikën “Ndërvarësia midis njerëzve, rajoneve dhe mjediseve”, në funksion të zhvillimit të kompetencave.

Rezultatet e të nxënit shprehen në terma njohurish, aftësish dhe qëndrimesh. Kombinimi dhe ndarja e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve në situata të nxëni, kapituj apo grupe temash e njësi mësimore, si dhe renditja e tyre është e drejtë e përdoruesve të programit (më kryesorët janë mësuesit dhe autorët e teksteve).

KLASA XII

TEMATIKA: NDËRVARËSIA MIDIS NJERËZVE, RAJONEVE DHE MJEDISEVE

Përshkrimi i tematikës:

Tematika “Ndërvarësia midis njerëzve, rajoneve dhe mjediseve” në klasën e 12-të të gjimnazit ka në fokusin e saj studimin e modeleve dhe proceseve të mjedisit fizik dhe human të rajoneve të veçanta dhe të botës në tërësi. Nëpërmjet studimit rajonal synohet që nxënësit, duke analizuar shpërndarjen hapësinore të dukurive gjeografike, të aftësohen për të gjetur zgjidhje dhe për të mbajtur qëndrime mbi proceset, dukuritë, modelet dhe marrëdhëniet midis tyre. Kjo mënyrë konceptimi u krijon nxënësve mundësinë të kuptojnë marrëdhëniet komplekse që ekzistojnë ndërmjet mjediseve fizike e humane të rajoneve të ndryshme.

Vështrimi rajonal i popullsisë, i kulturave, i zhvillimeve ekonomike etj. ndihmon nxënësit për të kuptuar e vlerësuar drejt kulturat dhe mënyrat e ndryshme të jetesës e të zhvillimit në botë. Përmes këtij studimi, nxënësi analizon raportet dhe lidhjet në nivel lokal, rajonal dhe global.

Me fokus dimensionin hapësinor të zhvillimeve globale, nxënësit orientohen drejt një “gjeografie çështjesh dhe problematikash” (ndërshtetërore, rajonale, globale). Në këtë mënyrë, tematika krijon mundësi eksplorimi ndaj tendencave të reja të globalizmit dhe multikulturalizmit. Në tërësi, programi krijon hapësira për studimin e thelluar të elementeve të gjeografisë fizike, veçanërisht të gjeografisë humane, duke kultivuar kuptimin dhe pranimin e ngjashmërive dhe të ndryshimeve ndërmjet popujve, shteteve dhe rajoneve të ndryshme europiane dhe botërore.

Kjo mënyrë trajtimi e tematikës së programit ngrihet mbi domosdoshmërinë e përgatitjes së nxënësve si qytetarë aktivë që të përballen e të mirëmenaxhojnë sfidat e së sotmes dhe të së ardhmes. Nxënësit përdorin njohuritë, mjetet dhe metodat e gjeografisë për të shqyrtuar këto çështje dhe për të sugjeruar rrugë të zgjidhjes së problemeve për çështje të ndryshme që lidhen me zhvillimin e ekonomisë, industrisë, bujqësisë, tregtisë, popullsisë, urbanizimit, me shumëllojshmërinë kulturore etj.

Grumbullimi dhe përpunimi i fakteve, i shifrave e të dhënave të ndryshme gjeografike, përmes shfrytëzimit të burimeve të ndryshme, përdorimit të teknologjisë, përdorimit të metodave statistikore, prezantimit grafik të tyre dhe interpretimit, mund të kthehen në një burim të vlefshëm për të organizuar orë mësimore interesante.

REZULTATET E TË NXËNIT

NËNTEMATIKA: GJEOGRAFIA DHE PROCESET GLOBALIZUESE

Njohuritë	Shkathhtësitë	Qëndrimet / vlerat
<p>) Karakteri ndërdisiplinor i studimit të gjeografisë si shkencë.</p> <p>) Drejtimet e karrierës së gjeografit.</p>	<p><i>Nxënësi:</i></p> <p>) <u>Analizon</u> dhe <u>vlerëson</u> karakterin ndërdisiplinor të gjeografisë si shkencë;</p> <p>) <u>shpjegon</u> rolin e saj për studimin e botës si një urë kalimi midis shkencave shoqërore dhe atyre natyrore;</p> <p>) <u>argumenton</u> rolin dhe rëndësinë e profesionit të gjeografit në fusha të ndryshme të jetës sociale dhe ekonomike;</p> <p>) <u>analizon</u> temat bazë në gjeografi: vendndodhja, vendi, rajoni, lëvizja, marrëdhëniet njeri-mjedis dhe proceset hapësinore;</p>	<p><i>Nxënësi:</i></p> <p>) <u>Demonstron</u>, përmes studimit të gjeografisë, aftësitë qytetare, të cilat ndihmojnë në rritjen personale si individ, në përgatitjen e tij në jetë, në punë dhe në shoqëri;</p> <p>) <u>vlerëson</u> dhe <u>respekton</u> pikëpamjet e të tjerëve;</p> <p>) <u>tregon</u> integritet në aksesimin dhe përdorimin etik të informacionit;</p> <p>) <u>paraqet</u> dhe <u>komunikon</u> lirshëm mendimet e tij;</p> <p>) <u>demonstron</u> objektivitet dhe paanësi;</p>

<p>)] Temat bazë të studimeve në gjeografinë e sotme bashkëkohore.</p> <p>)] Tipologjia e zhvillimeve lokale, rajonale dhe proceset globalizuese.</p>	<p>)] <u>analizon</u> dhe <u>vlerëson</u> proceset e sotme integruese dhe marrëdhëniet në nivele të ndryshme: lokal, rajonal dhe global;</p> <p>)] <u>vlerëson</u> tendencat e sotme globalizuese dhe problemet në këtë proces;</p> <p>)] <u>argumenton</u> qëndrimet pro dhe kundër këtyre proceseve.</p>	<p>)] <u>demonstron</u> pavarësi dhe besim në vetvete;</p> <p>)] <u>respekton</u> përpjekjet personale dhe ato në grup.</p>
---	--	---

NËNTEMATIKA: RAJONET GJEOGRAFIKE TË BOTËS

<p>)] Objekti i gjeografisë rajonale të botës dhe rëndësia e studimit të saj.</p> <p>Europa</p> <p>)] Tiparet e përgjithshme natyrore të Europës:</p> <p>- resurset natyrore më të rëndësishme për rajonin,</p>	<p><i>Nxënësi:</i></p> <p>)] <u>Përshkruan</u> objektin dhe rëndësinë e studimit të gjeografisë rajonale të botës;</p> <p>)] <u>vlerëson</u> ndërlidhjen e saj me fushat e tjera të studimit të gjeografisë;</p> <p>)] <u>vlerëson</u> rolin e pozitës gjeografike në karakteristikat e përgjithshme gjeografike të Europës dhe në marrëdhëniet me rajonet e tjera;</p>	<p><i>Nxënësi:</i></p> <p>Ñ <u>Vlerëson</u> dhe <u>respekton</u> shumëllojshmërinë sociale, kulturore dhe mjedisore;</p> <p>Ñ <u>demonstron</u> kuriozitet për rajonet dhe vendet në botë;</p> <p>Ñ <u>vlerëson</u> bashkëpunimin ndërmjet rajoneve dhe vendeve në botë;</p>
--	---	--

<ul style="list-style-type: none"> - tiparet dhe format kryesore të relievit, - sistemet ujore, - tiparet dhe rajonet kryesore klimatike, - tokat dhe brezat e bimësisë. <p>J Ndryshimi i hartës politike të Europës.</p> <p>J Popullsia e Europës dhe karakteristika të zhvillimeve demografike:</p> <ul style="list-style-type: none"> - ecuria e numrit të popullsisë dhe shpërndarja gjeografike; - strukturat e popullsisë në Europë. 	<p>J <u>përshkruan</u> veçoritë specifike rajonale natyrore të Europës:</p> <ul style="list-style-type: none"> - resurset natyrore më të rëndësishme për rajonin, - tiparet dhe format kryesore të relievit, - sistemet ujore, - tiparet dhe rajonet kryesore klimatike, - tokat dhe brezat e bimësisë; <p>J <u>vlerëson</u> ndikimin dhe rolin e veprimtarisë njerëzore në mjedisin natyror;</p> <p>J <u>dallon</u> etapat më të rëndësishme të ndryshimit të hartës politike të Europës;</p> <p>J <u>analizon</u> veçoritë e popullsisë së Europës dhe tendencat aktuale të zhvillimeve demografike në Europë;</p>	<p>Ë <u>vlerëson</u> dhe <u>shpreh</u> ndjeshmëri ndaj menaxhimit të qëndrueshëm të rajoneve;</p> <p>Ë <u>paraqet</u> dhe <u>komunikon lirshëm</u> mendimet e tij;</p> <p>Ë <u>respekton</u> përpjekjet personale dhe ato në grup;</p> <p>J <u>tregon</u> integritet në aksesimin dhe përdorimin etik të informacionit;</p> <p>J <u>është krijues</u> dhe prezanton idetë e reja të tij;</p> <p>J <u>demonstron</u> kuriozitet në eksplorimin e hartave të tematikave të ndryshme;</p> <p>J <u>ndan me të tjerët</u> përvojat dhe njohuritë e përfutuara nga vëzhgimet individuale;</p> <p>J <u>respekton</u> idetë dhe përvojat e prezantuara nga të tjerët;</p> <p>J <u>prezanton me objektivitet</u> rezultatet e ndryshme.</p>
--	---	--

<p>Harta ekonomike e Europës dhe tipare strukturore të ekonomisë në Europë.</p> <p>) Urbanizimi dhe tiparet kryesore të zhvillimeve aktuale në Europë.</p> <p>) Kultura europiane dhe shumëllojshmëria kulturore e Europës.</p> <p>) Bashkimi European dhe perspektiva të zhvillimit.</p> <p>) Nënrajonet kryesore të Europës: Europa Perëndimore, Europa Qendrore, Europa Veriore, Europa Ishullore, Europa Mesdhetare, Europa Lindore.</p>	<p>) <u>shpjegon</u> veçoritë kryesore të zhvillimit të sektorëve të ekonomisë europiane;</p> <p>) <u>vlerëson</u> perspektivën e zhvillimit ekonomik të Europës;</p> <p>) <u>analizon</u> veçoritë kryesore të proceseve urbanizuese në Europë dhe problemet që i shoqërojnë;</p> <p>) <u>identifikon</u> tipare të shumëllojshmërisë kulturore të Europës;</p> <p>) <u>interpret</u>on historikun dhe karakteristikat e formimit, zhvillimit e zgjerimit të BE-së;</p> <p>) <u>interpret</u>on zhvillimet aktuale dhe problematikat që i shoqërojnë;</p> <p>) <u>identifikon</u> disa ndër problemet e sotme rajonale të Europës dhe perspektivën e zgjidhjes së tyre;</p> <p>) <u>identifikon</u> nënrajonet kryesore të Europës;</p> <p>) <u>interpret</u>on për secilin nënrajon tiparet kryesore natyrore dhe tiparet socio-ekonomike;</p>	
--	--	--

<p>)] Tiparet natyrore dhe socio-ekonomike të secilit nënrajon.</p> <p>)] Shqipëria në Ballkanin Perëndimor dhe në Europë.</p>	<p>)] <u>vlerëson</u> pozitën gjeopolitike dhe gjeoekonomike të Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor dhe në Europë;</p>	
<p>Rusia</p> <p>)] Tiparet e përgjithshme natyrore të Rusisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - resurset natyrore më të rëndësishme për rajonin, - tiparet dhe format kryesore të relievit, - sistemet ujore, - tiparet dhe rajonet kryesore klimatike, - tokat dhe brezat e bimësisë. <p>)] Popullsia e Rusisë dhe karakteristika të zhvillimeve demografike.</p>	<p>)] <u>vlerëson</u> rolin e pozitës gjeografike të Rusisë në karakteristikat e përgjithshme gjeografike dhe marrëdhënien e saj me rajonet e tjera;</p> <p>)] <u>vlerëson</u> rolin e pasurive të shumta natyrore që ka Rusia në zhvillimin ekonomik të saj;</p> <p>)] <u>identifikon</u> veçoritë specifike rajonale natyrore të Rusisë;</p> <p>)] <u>vlerëson</u> ndikimin dhe rolin e veprimtarisë njerëzore në mjedisin natyror;</p> <p>)] <u>analizon</u> veçoritë e popullimit dhe tendencat aktuale të zhvillimeve demografike në rajonin rus, me fokus të veçantë shumëllojshmërinë etnike dhe shpërndarjen e popullsisë;</p> <p>)] <u>shpjegon</u> veçoritë kryesore të zhvillimit të sektorëve të ekonomisë në Rusi;</p>	

<p>J) Tiparet kryesore të zhvillimit ekonomik të makrorajonit rus.</p> <p>J) Tendenca të zhvillimeve aktuale gjeopolitike të makrorajonit rus dhe perspektiva e zhvillimit të tyre.</p>	<p>J) <u>interpret</u>on perspektivën e zhvillimit ekonomik të Rusisë;</p> <p>J) <u>vlerëso</u>n zhvillimet aktuale gjeopolitike të makrorajonit rus dhe problemet e sotme të perspektivës rajonale e globale;</p> <p>J) <u>përshkru</u>an tiparet kryesore natyrore të rajonit të Amerikës së Veriut:</p>	
<p>Amerika e Veriut</p>		
<p>J) Veçoritë natyrore kryesore të rajonit të Amerikës së Veriut:</p> <ul style="list-style-type: none"> - resurset natyrore më të rëndësishme për rajonin, - tiparet dhe format kryesore të relievit, - sistemet ujore, - tiparet dhe rajonet kryesore klimatike, - tokat dhe brezat e bimësisë. 	<ul style="list-style-type: none"> - resurset natyrore më të rëndësishme për rajonin, - tiparet dhe format kryesore të relievit, - sistemet ujore, - tiparet dhe rajonet kryesore klimatike, - tokat dhe brezat e bimësisë. <p>J) <u>vlerëso</u>n zhvillimin historiko-territorial rajonal të Amerikës së Veriut;</p>	
<p>J) Zhvillimi historik territorial rajonal i Amerikës së Veriut.</p>	<p>J) <u>shpjeg</u>on karakteristikat e përgjithshme të zhvillimeve demografike të Amerikës së Veriut;</p>	
<p>J) Tipare të modeleve të popullsisë së Amerikës së Veriut.</p>		

<p>)] Veçoritë e shumëllojshmërisë kulturore të rajonit të Amerikës së Veriut.</p> <p>)] Urbanizimi dhe tiparet kryesore të zhvillimeve aktuale në Amerikën e Veriut.</p> <p>)] Modelet ekonomike të zhvillimit të Amerikës së Veriut.</p> <p>)] Tendenca të zhvillimeve rajonale të Amerikës së Veriut.</p>	<p>)] <u>identifikon</u> dhe <u>vlerëson</u> tipare të shumëllojshmërisë kulturore të rajonit të Amerikës së Veriut;</p> <p>)] <u>vlerëson</u> shkallën e urbanizimit të Amerikës Veriore dhe perspektivën e zhvillimit;</p> <p>)] <u>analizon</u> tipet dhe llojet e ndryshme të rajoneve të ShBA-së dhe të Kanadasë, si dhe modelet e tyre të zhvillimit, duke evidentuar modelin ekonomik të zhvillimit të ShBA-së;</p> <p>)] <u>analizon</u> problemet e sotme të zhvillimeve rajonale të Amerikës së Veriut dhe parashikon perspektivën e tyre;</p> <p>)] <u>përshkruan</u> tiparet kryesore natyrore të Amerikës Qendrore, me fokus të veçantë specifikat e bimësisë së këtij rajoni (shtrirjen gjeografike, llojet etj.);</p>	
<p>Amerika Qendrore</p> <p>)] Veçoritë natyrore kryesore të rajonit të Amerikës Qendrore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - resurset natyrore më të rëndësishme për rajonin, - tiparet dhe format kryesore të relievit, 	<ul style="list-style-type: none"> - resurset natyrore më të rëndësishme për rajonin, - tiparet dhe format kryesore të relievit, 	

<ul style="list-style-type: none"> - sistemet ujore, - tiparet dhe rajonet kryesore klimatike, - tokat dhe brezat e bimësisë. <p>) Tiparet kryesore të zhvillimit historik territorial rajonal të Amerikës Qendrore.</p> <p>) Karakteristikat humane të rajonit të Amerikës Qendrore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - popullsia dhe veçoritë e saj; - shumëllojshmëria kulturore. <p>) Urbanizimi dhe tiparet kryesore të zhvillimeve aktuale në Amerikën Qendrore.</p> <p>) Veçoritë kryesore të zhvillimit ekonomik të Amerikës Qendrore.</p> <p>) Tendenca të zhvillimeve rajonale të Amerikës Qendrore.</p> <p>Amerika Jugore</p>	<ul style="list-style-type: none"> - sistemet ujore, - tiparet dhe rajonet kryesore klimatike, - tokat dhe brezat e bimësisë; <p>) <u>vlërëson</u> zhvillimin historiko-territorial rajonal të Amerikës Qendrore;</p> <p>) <u>shpjegon</u> veçoritë e popullimit dhe të kulturës së rajonit të Amerikës Qendrore, duke vlerësuar gërshetimin e kulturave;</p> <p>) <u>identifikon</u> veçoritë dhe shkallën e urbanizimit të Amerikës Qendrore;</p> <p>) <u>analizon</u> modelet e zhvillimit ekonomik të Amerikës Qendrore;</p> <p>) <u>analizon</u> problemet e sotme të zhvillimeve rajonale të Amerikës Qendrore, si dhe perspektivën e tyre;</p> <p>) <u>përshkruan</u> tiparet kryesore natyrore të Amerikës së Jugut:</p>	
--	---	--

<p>) Veçoritë kryesore natyrore të rajonit të Amerikës Jugore: <ul style="list-style-type: none"> - resurset natyrore më të rëndësishme për rajonin, - tiparet dhe format kryesore të relievit, - sistemet ujore, - tiparet dhe rajonet kryesore klimatike, - tokat dhe brezat e bimësisë. </p> <p>) Zhvillimi historik territorial rajonal i Amerikës Jugore. </p> <p>) Karakteristikat humane të rajonit të Amerikës Jugore: <ul style="list-style-type: none"> - popullsia dhe veçoritë e saj - shumëllojshmëria kulturore. </p> <p>) Urbanizimi dhe tiparet kryesore të zhvillimeve aktuale në Amerikës Jugore. </p> <p>) Veçoritë kryesore të zhvillimit ekonomik të Amerikës Jugore. </p> <p>) Tendenca të zhvillimeve rajonale të Amerikës Jugore. </p>	<p> - resurset natyrore më të rëndësishme për rajonin, <ul style="list-style-type: none"> - tiparet dhe format kryesore të relievit, - sistemet ujore, - tiparet dhe rajonet kryesore klimatike, - tokat dhe brezat e bimësisë; </p> <p>) <u>identifikon</u> tiparet kryesore të zhvillimit historik territorial rajonal të Amerikës Jugore; </p> <p>) <u>shpjegon</u> veçoritë e popullimit dhe të kulturës së rajonit të Amerikës Jugore, duke evidentuar diferencimin hapësinor të kulturave vendase dhe europiane; </p> <p>) <u>vlerëson</u> shkallën e urbanizimit të Amerikës Jugore dhe perspektivën e zhvillimit; </p> <p>) <u>analizon</u> modelet e zhvillimit ekonomik të Amerikës Jugore; </p> <p>) <u>interpret</u>on problemet e sotme të zhvillimeve rajonale të Amerikës Jugore dhe perspektivën e tyre; </p>	
---	--	--

Afrika Nën-Sahariane

) Veçoritë kryesore natyrore të rajonit të Afrikës Nën-Sahariane:

- resurset natyrore më të rëndësishme për rajonin,
- tiparet dhe format kryesore të relievit,
- sistemet ujore,
- tiparet dhe rajonet kryesore klimatike,
- tokat dhe brezat e bimësisë.

) Zhvillimi historik territorial rajonal i Afrikës Nën-Sahariane.

) Karakteristikat humane të rajonit të Afrikës Nën-Sahariane:

- popullsia dhe veçoritë e saj;
- veçoritë kulturore të rajonit.

) përshkruan tiparet fiziko-gjeografike të Afrikës Nën-Sahariane, duke evidentuar tipizimin e botës bimore dhe shtazore:

- resurset natyrore më të rëndësishme për rajonin,
- tiparet dhe format kryesore të relievit,
- sistemet ujore,
- tiparet dhe rajonet kryesore klimatike,
- tokat dhe brezat e bimësisë;

) përshkruan veçoritë kryesore të zhvillimit historiko-territorial rajonal të Afrikës Nën-Sahariane;

) identifikon dhe vlerëson veçoritë e popullimit dhe të kulturës së rajonit të Afrikës Nën-Sahariane;

) përshkruan shkallën e urbanizimit të Afrikës Nën-Sahariane dhe perspektivën e zhvillimit të saj;

<p>) Urbanizimi dhe tiparet kryesore të zhvillimeve aktuale në Afrikën Nënsahariane.</p> <p>) Tiparet kryesore të zhvillimit ekonomik të Afrikës Nënsahariane.</p> <p>) Tendenca të zhvillimeve rajonale të Afrikës Nënsahariane.</p>	<p>) <u>analizon</u> modelet e zhvillimit ekonomik të Afrikës Nënsahariane;</p> <p>) <u>analizon</u> problemet e sotme të zhvillimeve rajonale të Afrikës Nënsahariane, si dhe perspektivën e tyre;</p> <p>) <u>vlerëson</u> pozitën gjeografike të rajonit të Afrikës së Veriut/Azisë Jugperëndimore;</p> <p>) <u>analizon</u> tiparet specifike të kushteve natyrore të këtij rajoni:</p>	
<p>Afrika e Veriut/Azia Jugperëndimore</p> <p>) Veçoritë kryesore natyrore të rajonit të Afrikës së Veriut/Azisë Jugperëndimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - resurset natyrore më të rëndësishme për rajonin, - tiparet dhe format kryesore të relievit, - sistemet ujore, - tiparet dhe rajonet kryesore klimatike, - tokat dhe brezat e bimësisë. <p>) Zhvillimi historik territorial rajonal i Afrikës së Veriut/Azisë Jugperëndimore.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - resurset natyrore më të rëndësishme për rajonin, - tiparet dhe format kryesore të relievit, - sistemet ujore, - tiparet dhe rajonet kryesore klimatike, - tokat dhe brezat e bimësisë; <p>) <u>vlerëson</u> zhvillimin historiko-territorial rajonal të Afrikës së Veriut/Azisë Jugperëndimore;</p> <p>) <u>identifikon</u> dhe <u>vlerëson</u> veçoritë e popullimit dhe të kulturës së rajonit të</p>	

<p>) Karakteristikat humane të rajonit të Afrikës së Veriut/Azisë Jugperëndimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - popullsia dhe veçoritë e saj; - kompleksiteti kulturor dhe politik i rajonit. <p>) Urbanizimi dhe tiparet kryesore të zhvillimeve aktuale në Afrikën e Veriut/Azinë Jugperëndimore.</p> <p>) Tiparet kryesore të zhvillimit ekonomik të Afrikës së Veriut/Azisë Jugperëndimore.</p> <p>) Tendenca të zhvillimeve rajonale të Afrikës së Veriut/Azisë Jugperëndimore.</p>	<p>Afrikës së Veriut/Azisë Jugperëndimore, duke u ndalur në sfidën e Islamit;</p> <p>) <u>vlerëson</u> shkallën e urbanizimit të Afrikës së Veriut/Azisë Jugperëndimore dhe perspektivën e saj të zhvillimit;</p> <p>) <u>analizon</u> modelet e zhvillimit ekonomik të Afrikës së Veriut/Azisë Jugperëndimore, bazën e resurseve të naftës dhe rolin e saj në zhvillimin e rajonit;</p> <p>) <u>analizon</u> problemet e sotme të zhvillimeve rajonale të Afrikës së Veriut/Azisë Jugperëndimore, si dhe perspektivën e tyre;</p> <p>) <u>përshkruan</u> tiparet fiziko-gjeografike të Azisë Jugore, me fokus praninë e lartësive më të mëdha në botë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - resurset natyrore më të rëndësishme për rajonin, - tiparet dhe format kryesore të relievit, - sistemet ujore 	
<p>Azia Jugore</p> <p>) Veçoritë natyrore të rajonit të Azisë Jugore:</p>		

<ul style="list-style-type: none"> - resurset natyrore më të rëndësishme për rajonin, - tiparet dhe format kryesore të relievit, - sistemet ujore, - tiparet dhe rajonet kryesore klimatike, - tokat dhe brezat e bimësisë. <p>)] Zhvillimi historik territorial rajonal i Azisë Jugore.</p> <p>)] Karakteristikat humane të rajonit të Azisë Jugore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - popullsia dhe veçoritë e saj; - veçoritë kulturore të rajonit. <p>)] Urbanizimi dhe tiparet kryesore të zhvillimeve aktuale në Azisë Jugore.</p> <p>)] Tiparet kryesore të zhvillimit ekonomik të Azisë Jugore.</p> <p>)] Tendenca të zhvillimeve rajonale të Azisë Jugore.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - tiparet dhe rajonet kryesore klimatike, - tokat dhe brezat e bimësisë; <p>)] <u>vlerëson</u> zhvillimin historiko-territorial rajonal të Azisë Jugore;</p> <p>)] <u>identifikon</u> dhe <u>vlerëson</u> veçoritë e popullimit dhe të kulturës së rajonit të Azisë Jugore;</p> <p>)] <u>përshkruan</u> shkallën e urbanizimit të Azisë Jugore dhe perspektivën e zhvillimit;</p> <p>)] <u>analizon</u> modelet e zhvillimit ekonomik të Azisë Jugore;</p> <p>)] <u>analizon</u> problemet e sotme të zhvillimeve rajonale të Azisë Jugore, si dhe perspektivën e tyre;</p> <p>)] <u>përshkruan</u> tiparet fiziko-gjeografike të Azisë Juglindore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - resurset natyrore më të rëndësishme për rajonin, - tiparet dhe format kryesore të relievit, 	
---	---	--

<p>Azia Juglindore</p> <p>) Veçoritë kryesore natyrore të rajonit të Azisë Juglindore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - resurset natyrore më të rëndësishme për rajonin, - tiparet dhe format kryesore të relievit, - sistemet ujore, - tiparet dhe rajonet kryesore klimatike, - tokat dhe brezat e bimësisë. <p>) Zhvillimi historik territorial rajonal i Azisë Juglindore.</p> <p>) Karakteristikat humane të rajonit të Azisë Juglindore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - popullsia dhe veçoritë e saj; - veçoritë kulturore të rajonit. <p>) Urbanizimi dhe tiparet kryesore të zhvillimeve aktuale në Azisë Juglindore.</p> <p>) Tiparet kryesore të zhvillimit ekonomik të Azisë Juglindore.</p> <p>) Tendenca të zhvillimeve rajonale të Azisë Juglindore.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - sistemet ujore, - tiparet dhe rajonet kryesore klimatike, - tokat dhe brezat e bimësisë; <p>) <u>vlërëson</u> zhvillimin historiko-territorial rajonal të Azisë Juglindore;</p> <p>) <u>identifikon</u> dhe <u>vlërëson</u> veçoritë e popullimit dhe të kulturës së rajonit të Azisë Juglindore;</p> <p>) <u>përshkruan</u> shkallën e urbanizimit të Azisë Juglindore dhe perspektivën e zhvillimit;</p> <p>) <u>analizon</u> veçoritë e zhvillimit ekonomik të Azisë Juglindore, me fokus modelin e zhvillimit ekonomik të një prej shteteve të ashtuquajtura “tigrat e Azisë”;</p> <p>) <u>analizon</u> problemet e sotme të zhvillimeve rajonale të Azisë Juglindore, si dhe perspektivën e tyre;</p>	
--	--	--

Azia Lindore

J Veçoritë kryesore natyrore të rajonit të Azisë Lindore:

- resurset natyrore më të rëndësishme për rajonin,
- tiparet dhe format kryesore të relievit,
- sistemet ujore,
- tiparet dhe rajonet kryesore klimatike,
- tokat dhe brezat e bimësisë.

J Zhvillimi historik territorial rajonal i Azisë Lindore.

J Karakteristikat humane të rajonit të Azisë Lindore:

- popullsia dhe veçoritë e saj;
- tiparet kulturore të rajonit.

J Urbanizimi dhe tiparet kryesore të zhvillimeve aktuale në Azisë Lindore.

J vlërëson pozitën gjeografike të rajonit të Azisë Lindore;

J përshkruan tiparet specifike të kushteve natyrore të këtij rajoni:

- resurset natyrore më të rëndësishme për rajonin,
- tiparet dhe format kryesore të relievit,
- sistemet ujore,
- tiparet dhe rajonet kryesore klimatike,
- tokat dhe brezat e bimësisë;

J vlërëson zhvillimin historiko-territorial rajonal të Azisë Lindore;

J identifikon dhe vlërëson veçoritë e popullimit dhe të kulturës së rajonit të Azisë Lindore;

J vlërëson shkallën e urbanizimit të Azisë Lindore dhe perspektivën e zhvillimit;

J analizon modelet e zhvillimit ekonomik të Azisë Lindore, me fokus të veçantë modelin kinez dhe atë japonez;

<p>J) Modelet kryesore të zhvillimit ekonomik të Azisë Lindore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - modeli kinez, - modeli japonez, <p>J) Tendenca të zhvillimeve rajonale të Azisë Lindore.</p> <p>Australia, Oqeania</p> <p>J) Veçoritë kryesore natyrore të rajonit të Australisë dhe Oqeanisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - resurset natyrore më të rëndësishme për rajonin, - tiparet dhe format kryesore të relievit, - sistemet ujore, - tiparet dhe rajonet kryesore klimatike, - tokat dhe brezat e bimësisë. <p>J) Tipare kryesore të zhvillimit historik territorial rajonal të Australisë dhe Oqeanisë.</p> <p>J) Karakteristikat humane të rajonit të Australisë dhe Oqeanisë:</p>	<p>J) <u>analizon</u> problemet e sotme të zhvillimeve rajonale të Azisë Lindore, si dhe perspektivën e tyre;</p> <p>J) <u>përshkruan</u> tiparet fiziko-geografike të Australisë dhe Oqeanisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - resurset natyrore më të rëndësishme për rajonin, - tiparet dhe format kryesore të relievit, - sistemet ujore, - tiparet dhe rajonet kryesore klimatike, - tokat dhe brezat e bimësisë; <p>J) <u>vlerëson</u> zhvillimin historiko-territorial rajonal të Australisë dhe Oqeanisë;</p> <p>J) <u>identifikon</u> dhe <u>vlerëson</u> veçoritë e popullimit dhe të kulturës së rajonit të Australisë dhe Oqeanisë;</p> <p>J) <u>përshkruan</u> shkallën e urbanizimit të Australisë dhe Oqeanisë dhe perspektivën e zhvillimit;</p>	
--	--	--

<ul style="list-style-type: none"> - popullsia dhe veçoritë e saj, - veçoritë kulturore të rajonit. <p>)] Urbanizimi dhe tiparet kryesore të zhvillimeve aktuale në Australisë dhe Oqeanisë.</p> <p>)] Tiparet kryesore të zhvillimit ekonomik të Australisë dhe Oqeanisë.</p> <p>)] Tendenca të zhvillimeve rajonale të Australisë dhe Oqeanisë.</p>	<p>)] <u>analizon</u> veçoritë e zhvillimit ekonomik të Australisë dhe Oqeanisë;</p> <p>)] <u>analizon</u> problemet e sotme të zhvillimeve rajonale të Australisë dhe Oqeanisë, si dhe perspektivën e tyre.</p>	
---	--	--

NËNTEMATIKA: SFIDAT E BOTËS GLOBALE

<p>)] Tendencat e sotme të popullsisë në botë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - ndryshimet e numrit të popullsisë dhe shpërndarja gjeografike në botë; - mbipopullimi dhe presioni demografik mbi territorin; - struktura e popullsisë (moshore, gjinore, sociale, profesionale). 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <p>)] <u>Identifikon</u> tendencat e ndryshimit të numrit të popullsisë në botë dhe shpërndarjes gjeografike të saj;</p> <p>)] <u>analizon</u> rritjen e popullsisë në vendet e zhvilluara dhe vendet në zhvillim, faktorët që ndikojnë në këtë rritje dhe shpërndarjen e popullsisë;</p>	<p><i>Nxënësi:</i></p> <p>)] <u>Vlerëson me objektivitet</u> rezultatet e të dhënave krahasuar me ato të shokëve;</p> <p>)] <u>respekton</u> idetë dhe përvojat e prezantuara nga të tjerët;</p> <p>)] <u>demonstron kuriozitet</u> në eksplorimin e hartave të tematikave të ndryshme;</p>
--	--	---

<p>J Modelet dhe teoritë mbi ndryshimet e popullsisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - teoritë populiste - teoritë antipopuliste <p>J Migrimet e popullsisë, tipet e migrimeve strategjitë rajonale dhe globale për kontrollin e tyre.</p>	<p>J <u>përshkruan</u> tipare dhe pasoja të mbipopullimit dhe presionit demografik mbi territorin;</p> <p>J <u>identifikon</u> qytetet më të populluara sot në botë;</p> <p>J <u>bën</u> dallimin ndërmjet modeleve dhe teorive populiste dhe antipopuliste të ndryshimeve të popullsisë;</p> <p>J <u>analizon</u> faktorët kryesorë që ndikojnë në proceset migratore në botë;</p> <p>J <u>analizon</u> ecuritë e të dhënave të mbledhura dhe të paraqitura grafikisht të disa modeleve tipike demografike botërore;</p> <p>J <u>përshkruan</u> stadet e migracionit të brendshëm nga zonat rurale drejt zonave urbane në rajone apo shtete të ndryshme të botës, shoqëruar me raste studimore;</p> <p>J <u>evidenton</u> dhe <u>vlerëson</u> strategjitë për uljen e migracionit nga zonat rurale drejt zonave urbane;</p>	<p>Ë <u>ndan me të tjerët</u> përvojat dhe njohuritë e përftuara nga vëzhgimet individuale;</p> <p>Ë <u>vlerëson</u> dhe <u>respekton</u> shumëllojshmërinë sociale, kulturore dhe mjedisore;</p> <p>Ë <u>vlerëson</u> bashkëpunimin ndërmjet rajoneve dhe vendeve në botë.</p>
--	--	---

<p>) Migrimet e shqiptarëve në botë, shkaqet, pasojat, perspektiva e zhvillimeve migratore në vendin tonë.</p>	<p>) <u>analizon</u> shkaqet e migracionit të jashtëm dhe pasojat e tij përmes rasteve studimore nga vende të ndryshme;</p> <p>) <u>evidenton</u> disa ndër strategjitë për kontrollin e emigracionit, duke veçuar strategjitë e BE-së lidhur me këtë dukuri;</p> <p>) <u>prezanton</u> historikun e emigrimit të shqiptarëve në botë përmes të dhënave të shfrytëzuara nga burime të ndryshme informacioni;</p> <p>) <u>analizon</u> shkaqet e emigracionit të jashtëm në Shqipëri pas viteve '90 dhe pasojat e tij;</p> <p>) <u>diskuton</u> mbi disa ndër strategjitë për zgjidhjen e këtyre problematikave;</p> <p>) <u>vlerëson</u> rolin e lëvizjeve migruese të shqiptarëve në zhvillimet ekonomike të vendit;</p> <p>) <u>hulumton</u> në burime të ndryshme informacioni mbi migracionin e brendshëm në Shqipëri, karakteristikat,</p>	
--	---	--

<p>) Rajonet gjuhësore dhe karakteristikat e zhvillimit, shpërndarja hapësinore e tyre dhe proceset integruese shumëkulturore.</p> <p>) Grupet etnike dhe shumëkulturalizmi, problemet etnike më të spikatura në botë dhe shpërndarja hapësinore e tyre, perspektiva të zgjidhjes së tyre.</p>	<p>shkaqet, pasojat dhe strategjitë për menaxhimin e tij;</p> <p>) <u>përcakton</u> shpërndarjen hapësinore të gjuhëve më të përhapura sot në botë dhe rajonet gjuhësore me veçoritë e tyre të zhvillimit;</p> <p>) <u>përshkruan</u> disa ndër politikat për mbijetesën e gjuhëve të pakicave;</p> <p>) <u>analizon</u> përhapjen rajonale të gjuhëve indoeuropiane, problematika që lidhen me to, përmes hulumtimit në burime të ndryshme informacioni (materiale burimore, internet, media etj.);</p> <p>) <u>tregon</u> shpërndarjen hapësinore të problemeve etnike më të spikatura përmes rasteve studimore;</p> <p>) <u>identifikon</u> shkaqet e tyre dhe problemet që i shoqërojnë;</p> <p>) <u>vlerëson</u> politikat dhe perspektivat e zgjidhjes së disa prej problemeve etnike më të spikatura në botë;</p>	
--	--	--

<p>) Fetë dhe shumëkulturalizmi, shpërndarja hapësinore e besimeve fetare.</p>	<p>) <u>tregon</u> shpërndarjen hapësinore të besimeve fetare më të përhapura sot;</p>	
<p>) Ekonomia globale, proceset ekonomike globalizuese dhe tendenca të zhvillimit të saj.</p>	<p>) <u>vlerëson</u> disa ndër problematikat/konfliktet më të spikatura fetare dhe rajonet e tyre;</p>	
	<p>) <u>përshkruan</u> shpërndarjen e pabarabartë të të mirave materiale në shkallë botërore dhe rajonale;</p>	
	<p>) <u>analizon</u> faktorët që ndikojnë në zhvillimin ekonomik të vendeve të zhvilluara dhe vendeve në zhvillim, shoqëruar me shembuj;</p>	
	<p>) <u>vlerëson</u> vendin e ekonomisë europiane në ekonominë botërore, rolin dhe tendencat e zhvillimit;</p>	
	<p>) <u>analizon</u> lëvizshmërinë e veprimtarive të ekonomisë moderne, faktorët që ndikojnë dhe pasojat e kësaj lëvizshmërie;</p>	
	<p>) <u>vlerëson</u> bashkëpunimet shumëkombëshe (si General Electric, Toyota etj.) si mjet suksesi në treg;</p>	

<p>) Bujqësia globale, tipologjia e rajoneve bujqësore.</p>	<p>) <u>analizon</u> tiparet e zhvillimit të bujqësisë në kushtet e globalizmit;</p>	
<p>) Proceset globalizuese dhe zhvillimet industriale, modelet e industrisë botërore dhe perspektiva të zhvillimit.</p>	<p>) <u>evidenton</u> tipologjinë e rajoneve bujqësore në botë sot, shoqëruar me shembuj;</p>	
<p>) Zhvillimi i sektorit terciar, karakteristika të zhvillimeve globale të këtij sektori.</p>	<p>) <u>përshkruan</u> veçoritë e revolucionit të gjelbër dhe pasojat e tij në zhvillimin e rajoneve ku është zhvilluar;</p> <p>) <u>identifikon</u> modelet e industrisë botërore dhe tendencat e zhvillimit të saj në ditët e sotme;</p> <p>) <u>përshkruan</u> pasojat e zhvillimeve industriale dhe revolucionin teknologjik (fazat, ndryshimet sot);</p> <p>) <u>analizon</u> zhvillimin e sektorit të shërbimeve, tendencat dhe shkaqet e zgjerimit të tij;</p> <p>) <u>rajonizon</u> shpërndarjen gjeografike të sektorit të shërbimeve sot në botë;</p> <p>) <u>identifikon</u> karakteristikat e zhvillimit të rrjetit botëror të transporteve sot, shoqëruar me shembuj;</p>	

<p>) Turizmi, llojet dhe perspektiva e zhvillimit rajonal dhe global.</p> <p>) Tregtia globale, roli, rëndësia dhe pasojat e saj. Roli i organizmave ndërkombëtarë në tregtinë botërore.</p>	<p>) <u>interpret</u>on “konfliktin” midis zhvillimit të rrjetit të transporteve përkundrejt mjedisit dhe strategjitë për menaxhimin e tij;</p> <p>) <u>përshkruan</u> zhvillimin e telekomunikacionit sot dhe tiparet e zhvillimit, shoqëruar me shembuj;</p> <p>) <u>përshkruan</u> llojet kryesore të turizmit;</p> <p>) <u>identifikon</u> rajonet turistike më të spikatura në botë dhe <u>dallon</u> disa ndër specifikat e tyre;</p> <p>) <u>vlerëson</u> perspektivën rajonale të zhvillimit të turizmit në Shqipëri;</p> <p>) <u>analizon</u> natyrën globale të tregtisë dhe rëndësinë e këtij sektori, shoqëruar me studime rasti;</p> <p>) <u>vlerëson</u> peshën që zënë në tregtinë globale produkte, si: nafta, hekuri, gruri, makinat etj.;</p> <p>) <u>interpret</u>on rolin e organizmave ndërkombëtarë, si OBT, NAFTA, OPEC,</p>	
--	---	--

<p>) Varfëria në botë, shpërndarja hapësinore dhe faktorët që ndikojnë, problematika dhe strategji globale.</p> <p>) Kriza e ujit dhe menaxhimi i burimeve ujore.</p> <p>) Urbanizimi, karakteristika të zhvillimeve urbane, modelet e qyteteve botërore, pasoja rajonale dhe globale të procesit të urbanizimit.</p>	<p>G8, BE, dhe politikat e tyre në tregtinë botërore;</p> <p>) <u>identifikon</u> avantazhet dhe disavantazhet që shoqërojnë globalizimin e tregtisë në botë;</p> <p>) <u>rajonizon</u> shpërndarjen gjeografike të varfërisë;</p> <p>) <u>analizon</u> faktorët që ndikojnë në këtë shpërndarje (duke qëndruar në faktorët humanë);</p> <p>) <u>vlerëson</u> perspektivën e kësaj problematike;</p> <p>) <u>identifikon</u> rajonet që përballen me pamjaftueshmërinë e rezervave ujore;</p> <p>) <u>vlerëson</u> masat që duhen marrë për mirëmenaxhimin e burimeve ujore;</p> <p>) <u>analizon</u> karakteristikat e qendrave urbane dhe rurale, tendencën e rritjes së shkallës së urbanizimit sot në botë;</p> <p>) <u>identifikon</u> problematikat në rajonet urbane;</p>	
---	--	--

<p>Urbanizimi në Shqipëri, tipare të zhvillimit të ndarjes territoriale të saj.</p> <p>Zhvillimi i qëndrueshëm, politikat rajonale dhe globale të zhvillimit, strategji që çojnë drejt tij.</p>	<p>)] <u>analizon</u> procesin e urbanizimit në rajonet periferike;</p> <p>)] <u>përshkruan</u> veçoritë e funksionimit dhe zhvillimit të megaqyteteve sot në botë;</p> <p>)] <u>përshkruan</u> procesin e urbanizimit dhe diferencimet rajonale;</p> <p>)] <u>krahason</u>, përmes shembujve, modele të ndarjes administrative dhe të decentralizimit të qeverisjes;</p> <p>)] <u>përshkruan</u> historikun e urbanizimit në Shqipëri;</p> <p>)] <u>identifikon</u> problematikat dhe pasojat e proceseve urbanizuese në Shqipëri pas viteve '90;</p> <p>)] <u>vlerëson</u> ndikimin e procesit të urbanizimit në mjedis;</p> <p>)] <u>përshkruan</u> veçoritë e ndarjes së sotme administrative në Shqipëri dhe problemet që janë evidentuar;</p> <p>)] <u>përshkruan</u> konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe rëndësinë e tij;</p>	
---	--	--

<p> J Burimet energjetike dhe kriza globale, menaxhimi i qëndrueshëm i tyre. </p> <p> J Ekosistemet natyrore, faktorët që ndikojnë mbi to, masa dhe strategji për ruajtjen e ekuilibrave natyrore. </p>	<p> J <u>vlërëson</u> rëndësinë e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik përmes koordinimit të politikave rajonale me ato globale të zhvillimit; </p> <p> J <u>identifikon</u> rrugë dhe strategji drejt një zhvillimi të qëndrueshëm industrial, bujqësor dhe urban; </p> <p> J <u>analizon</u> shpërndarjen gjeografike të burimeve të energjisë në botë; </p> <p> J <u>interpret</u>on perspektivën e zhvillimit dhe të shpërndarjes së energjisë në botë; </p> <p> J <u>përshkruan</u> përdorimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë sot në botë (energjinë e erës, diellit, ujit, biomasën, energjinë atomike) shoqëruar me shembuj, duke veçuar vendet tipike të shfrytëzimit të secilës; </p> <p> J <u>analizon</u> faktorët që ndikojnë në prishjen e ekuilibrit në ekosisteme të rëndësishme (p.sh., shpyllëzimet në Indonezi, pellgun e Amazonës etj.) si dhe pasojat për mjedisin; </p>	
---	---	--

<p>) Ndryshimet klimatike, pasojat që i shoqërojnë, ndikimi i veprimtarisë njerëzore dhe politikat rajonale e botërore në lidhje me to. </p> <p>) Ndotja si proces global. </p> <p>) Zhvillimet gjeopolitike dhe proceset globale, tendencat aktuale dhe perspektiva të trajtimit të tyre. </p>	<p>) <u>identifikon</u> shkaqet dhe pasojat e përmbytjeve të shumta sot në botë, shoqëruar me shembuj; </p> <p>) <u>vlerëson</u> rëndësinë e mbrojtjes së pyjeve dhe kujdesit për shtretërit e lumenjve; </p> <p>) <u>analizon</u> shkaqet dhe pasojat e ndryshimeve klimatike; </p> <p>) <u>vlerëson</u> politikat botërore e rajonale për menaxhimin e këtyre ndryshimeve; </p> <p>) <u>interpret</u> ndotjen si proces global; </p> <p>) <u>vlerëson</u> faktorët që ndikojnë dhe pasojat që e shoqërojnë; </p> <p>) <u>identifikon</u> rajonet me ndotjen më të madhe në botë; </p> <p>) <u>vlerëson</u> shkallën e ndikimit të llojeve të ndryshme të ndotjeve në mjedis dhe masat që mund të merren për reduktimin e tyre; </p> <p>) <u>përshkruan</u> ndryshimet e hartës politike të botës (dekolonizimin) deri në Luftën e Dytë Botërore dhe evolucionin e saj pas Luftës së Dytë Botërore; </p>	
--	--	--

<p>J) Tregtia dhe trafikimi i armëve, konfliktet rajonale dhe politikat botërore mbi çarmatimin.</p>	<p>J) <u>analizon</u> krijimin e shteteve të reja pas rënies së murit të Berlinit (kushtet, faktorët), problematikat që kanë shoqëruar zhvillimin e tyre, shoqëruar me shembuj;</p> <p>J) <u>përshkruan</u> polet e Fuqive të Mëdha, kushtet të cilat i favorizojnë këto vende për të qenë të tilla;</p> <p>J) <u>përshkruan</u> raportet që kanë vendet pole me vendet e tjera;</p> <p>J) <u>analizon</u>, përmes shembujve, krijimin e poleve të refugjatëve sot në botë, tendencën e krijimit të tyre;</p> <p>J) <u>vlerëson</u> perspektivën e këtyre poleve;</p> <p>J) <u>analizon</u> faktorët që nxisin tregtinë dhe trafikun e armëve, korridoret e trafikimit dhe konfliktet rajonale, shoqëruar me shembuj;</p> <p>J) <u>vlerëson</u> dhe <u>diskuton</u> mbi politikat në nivel europian dhe botëror për çarmatimin;</p>	
--	---	--

	<p>) <u>identifikon</u> vendet që konsiderohen si fuqi bërthamore botërore, shoqëruar me shembuj të specifikave të tyre;</p> <p>) <u>vlerëson</u> politikat botërore për parandalimin e prodhimit të armëve bërthamore;</p> <p>) <u>hulumton</u> mbi historikun e përdorimit të fuqisë bërthamore.</p>	
--	--	--

4. UDHËZIME METODOLOGJIKE

Metodat, teknikat, strategjitë e mësimdhënies, në lëndën e gjeografisë, janë faktorë të rëndësishëm për një mësimdhënie të suksesshme që nxit interesin, gjithëpërfshirjen, ndërveprimin dhe punën kërkimore të nxënësve.

Përzgjedhja dhe përdorimi i tyre nga mësuesit bëhet në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve, duke respektuar stilet e ndryshme të të nxënësve të tyre.

Mësimdhënia dhe të nxënësve, bazuar në kompetenca, kërkon që, në përzgjedhjen dhe përdorimin e strategjive, teknikave dhe metodave të mësimdhënies, mësuesit e kësaj lënde:

-) të marrin parasysh njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet paraprake të nxënësve, që nënkupton përvojat individuale të tyre dhe, mbi këtë bazë, të mbështesin e orientojnë të nxënësve të tyre;
-) të nxisin vërtetimin e drejtpërdrejtë, kureshtjen, arsyetimin dhe gjykimin nëpërmjet demonstrimeve dhe vëzhgimeve në natyrë;
-) të nxisin të menduarit kritik e krijues dhe zgjidhjen e problemeve;
-) të motivojnë nxënësve, duke e konsideruar si partner, në kuptimin që, në procesin mësimor, mësuesi dhe nxënësi janë plotësues të njëri-tjetrit;
-) të mbështesin të nxënësve të pavarur dhe në bashkëpunim të nxënësve përmes punës me projekte, punës në grup, punës individuale;
-) të mbajnë parasysh integrimin dhe marrëdhënien ndërmjet lëndëve të fushës “Shoqëria dhe mjedisi”, zbatimet e tyre në jetën e përditshme, si dhe lidhjen ndërlëndore;
-) të shfrytëzojnë burime të shumëllojshme informacioni dhe ta çmojnë tekstin si një burim të rëndësishëm, por të pamjaftueshëm për përmbushjen e kompetencave të fushës;
-) të përdorin TIK-un si mbështetës dhe lehtësues të mësimdhënies dhe të të nxënësve.

Rolet që ndërmarrin nxënësi dhe mësuesi në realizimin e kësaj qasjeje, janë:

-) *Nxënësi si veprues dhe i interesuar.* Në gjeografi, nxënësi studion dukuritë dhe proceset gjeografike. Ai nxitet të kërkojë përgjigje për pyetjet që ngre, duke hulumtuar në burime të ndryshme dhe duke përdorur teknika specifike të gjeografisë. Nxënësi angazhohet të vendosë lidhje ndërmjet asaj që di dhe asaj që zbulon dhe, mbi këtë bazë, ndërton dijen e tij, bashkëvepron me shokët/shoqet dhe mësuesin, ndan me ta vëzhgimet dhe përvojat e tij. Ai punon individualisht ose në grup dhe mbështetet nga mësuesi.
-) *Nxënësi si partner.* Partneriteti i mësuesit me nxënësin në mësimdhënie rrit motivimin dhe e bën mësimdhënien më tërheqëse, duke krijuar kushte që ajo të jetë e suksesshme.
-) *Mësuesi si udhëheqës dhe lehtësues.* Mësuesi i gjeografisë ndihmon nxënësit të zbulojnë kënaqësitë e të nxënit. Roli i mësuesit konsiston në udhëheqjen e nxënësve; ai drejton nxënësit në eksplorimin e dukurive gjeografike. Mësuesi vepron si moderator midis dijes dhe nxënësit, duke e ndihmuar nxënësin të përfshihet në procesin e ndërtimit të dijes. Ai krijon kontekste të nxëni, të cilat i aftësojnë nxënësit të përftojnë mjetet e gjeografit. Zbatimi i programit kërkon që mësuesi të përdorë strategji mësimdhënieje duke respektuar stilet e të nxënit të nxënësve. Ai i angazhon nxënësit në ndërtimin e mendimit, duke nxitur diskutimet dhe ballafaqimin e këndvështrimeve të ndryshme.

Mësimdhënia dhe të nxënit në gjeografi duhet të mbështeten në situata të jetës reale. Të nxënit fillon kur nxënësit përpiqen të zgjidhin probleme dhe të eksplorojnë situata të jetës reale për të gjetur përgjigjet e pyetjeve që kanë, ose për të zgjidhur probleme. Të nxënit me situata përfshin pjesëmarrjen e nxënësve në detyra që janë të ngjashme me zbatimet në botën reale. Kërkimi, analiza dhe përzgjedhja e të dhënave duhet të jenë gjithmonë pjesë e situatave të të nxënit. Ato duhet të mbështeten në kërkimin gjeografik, i cili përfshin analizën krahasuese të dukurive gjeografike në shkallë të ndryshme. Këto lloj situatash kërkojnë zhvillimin e shprehive të të pyeturit, analizës, mendimit kritik dhe krijues.

Programi i gjeografisë në klasën XII u krijon nxënësve hapësirë dhe mundësi situatash të nxëni përmes punës dhe vëzhgimeve në terren, përmes diskutimit të çështjeve aktuale në nivel lokal dhe global, të tilla si ndryshimet klimatike, përmes analizave të zhvillimeve demografike dhe ekonomike të rajoneve etj.

Nxënësit me nevoja të veçanta

Organizimi i kurrikulës sipas kompetencave, në fusha të nxëni, në shkallë dhe me fokus integrimin, u krijon mësuesve hapësirat për të përshtatur mësimdhënien sipas nevojave të veçanta të nxënësve dhe për të personalizuar të nxënit e tyre. Mësuesit duhet të marrin parasysh faktin se nxënësit janë të ndryshëm, kanë motivim, interesa, stile të nxëni, nevoja dhe aftësi të ndryshme etj. Në disa raste duhen bërë përshtatje të kurrikulës sipas diferencave të zhvillimit brenda një grup-moshe. Mësuesit mund të zgjerojnë zhvillimin e kompetencave kyçe, si ato të komunikimit, të menduarit dhe shoqërore, sipas nevojave individuale të nxënësve, për të zvogëluar dhe zhdukur diferencat brenda një shkalle të kurrikulës, në fund të saj.

Nxënësit me vështirësi në të nxënë

Shumë nxënës me vështirësi arrijnë rezultatet e pritshme të të nxënit njësoj si nxënësit e tjerë, nëse bëhen përshtatje në mënyrën e mësimdhënies dhe të vlerësimit të tyre.

Për të arritur nivelin më të lartë të mundshëm të realizimit të kompetencës, mund të zhvillohen programe të veçanta, individuale, për nxënësit me nevoja të veçanta.

Në rastin e nxënësve që formalisht janë përcaktuar si të veçantë, është veçanërisht e rëndësishme që stafi i shkollës, në bashkëpunim me prindërit, të mbështesë të nxënit e tyre. Procedurat dhe teknikat e vlerësimit për nxënës me nevoja të veçanta duhet të diskutohen herë pas here me prindërit dhe vetë nxënësit. Prindërit duhet të kuptojnë se si ndikojnë këto procedura dhe teknika të përshtatura në vlerësimin e punës së nxënësve.

Nxënësit e talentuar

Fleksibiliteti i zhvillimit të programit lejon plotësimin e nevojave individuale të nxënësve të talentuar.

Mësuesit duhet të krijojnë kushte dhe situata të tilla që nxënësit të shfaqin dhe të zhvillojnë talentet e tyre. Kjo arrihet nëse nxënësve u krijohen mundësitë të punojnë me një përmbajtje më të thelluar dhe të zgjeruar, të zhvillojnë në mënyrë të vazhdueshme elemente specifike të kompetencave kyçe (p.sh., aftësitë e nivelit të lartë konjitiv të kompetencës së të menduarit) dhe specifike të fushës, të fokusohen në çështjet kroskurrikulare, të zgjerojnë mjediset dhe materialet e të nxënit brenda dhe jashtë shkollës.

5. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

Vlerësimi është pjesë integrale e procesit të mësimdhënies dhe të nxënimit. Vlerësimi mat shkallën në të cilën janë arritur (nga nxënësit) njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e dëshiruara. Ai përfshin mbledhjen e informacioneve me anë të teknikave të ndryshme të vlerësimit për arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënimit në nivel klase dhe shkalle. Me këtë informacion, mësuesi merr vendime për vlerësimin përfundimtar të nxënësit, bazuar në gjykimin e tij për nivelin e zotërimit nga nxënësi të kompetencave të fushës “Shoqëria dhe mjedisi”. Vlerësimi u shërben mësuesve për të përmirësuar metodat e mësimdhënies, nxënësve për të përmirësuar të nxënimit dhe prindërve për të monitoruar progresin e fëmijëve të tyre në shkollë.

Mësuesit duhet të përdorin situata të jetës reale si pikënisje për vlerësimin e nxënësve. Format e ndryshme të vlerësimit duhet t’u krijojnë mundësi të gjithë nxënësve të vlerësohen në atë mënyrë që është më e përshtatshme për ta.

Për vlerësimin e nxënësve, mësuesit duhet të mbështeten në disa parime bazë:

-)] Vlerësimi duhet të jetë i ndershëm dhe i paanshëm. Nxënësit duhet t’i jepet mundësia të demonstrojnë shkallën e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve.
-)] Vlerësimi duhet t’i ndihmojë nxënësit. Ai duhet t’u japë informacion pozitiv dhe nxitës për t’u përfshirë aktivisht në procesin e të nxënimit.
-)] Vlerësimi udhëhiqet nga rezultatet e të nxënimit dhe shfrytëzon shumëllojshmëri strategjish dhe teknikash vlerësimi.

Disa ndër to mund të jenë:

-)] Vlerësimi me gojë (të pyeturit, diskutimi, debati etj.).
-)] Vlerësimi përmes punëve praktike.
-)] Vlerësimi përmes projekteve kurrikulare, lëndore ose ndërlëndore.
-)] Vlerësimi me shkrim (detyra të veçanta për grupe nxënësish, testime, detyra në grup ose individualisht).

Mësuesi vlerëson nxënësin edhe përmes përdorimit të portofolit. Ai është një koleksion sistematik i punës së nxënësve dhe siguron një tablo të plotë të arritjes së tyre. Punët e mbledhura ofrojnë të dhëna të shumta për zhvillimin dhe progresin e nxënësve në përvetësimin e njohurive, të kuptuarit e koncepteve, zbatimin e shkathtësive dhe zhvillimin e qëndrimeve. Mësuesi, gjithashtu, u afron nxënësve mundësi për vetëvlerësim dhe reflektim përmes rishikimit të portofoleve të tyre.

6. MATERIALET DHE BURIMET MËSIMORE

Përdorimi i mjeteve mësimore në mësimdhënien dhe procesin e të nxënësve në fushën “Shoqëria dhe mjedisi” ndihmon në konkretizimin e ideve dhe dukurive, në zbatimin e metodave dhe strategjive të mësimdhënies, si dhe e bën mësimin më interesant dhe më argëtues për nxënësin. Përdorimi i suksesshëm i metodave dhe i teknikave të lartpërmendura nuk mund të realizohet pa mjetet e nevojshme didaktike, të cilat mund të jenë të llojeve të ndryshme, si: harta të përgjithshme ose tematike, atlase, albume, fotografi, skica, filma mësimorë, videokaseta, kompjuter, aparat projektimi, CD, DVD etj.;

Mësuesi është përgjegjës për krijimin e një mjedisi stimulues. Ai duhet të sigurojë që nxënësi të ketë akses në burimet e ndryshme të të nxënësve. Lista e burimeve të vlefshme për zhvillimin e kompetencave në gjeografi është e larmishme: muze, harta, plane, piktura, dokumente historike, dokumente audiovizive etj. Gjithashtu, burimet përfshijnë teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit që nxënësit i përdorin si mjete kërkimi dhe për përgatitjen e projekteve dhe detyrave të ndryshme.

Sugjerime për përdorimin e TIK-ut

-) Përdorimi i postës elektronike për shkëmbim informacioni.
-) Përdorimi i internetit për të shfrytëzuar faqet e internetit (*website*) për gjeografinë.
-) Përdorimi i CD-ROM për mbledhjen e informacionit mbi temat që nxënësi studion.
-) Organizimi dhe prezantimi i të dhënave, duke përdorur tipa të ndryshëm programi (*software*).
-) Përdorimi i simulimeve *software*.
-) Përdorimi i grafikëve *software*.
-) Paraqitja grafike e të dhënave.